



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1045

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Botek shpk, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KOMUNA SUHAREKËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me paisje teknologjike (kompjuterë, lloptopë, videoprojektora dhe paisje tjera)” me numër të prokurimit 624-23-13123-5-5-8, me 27/02/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar ankesa e OE Botek shpk me nr. 2023/1045, e datës 25/12/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA SUHAREKË lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me paisje teknologjike (kompjuterë, lloptopë, videoprojektora dhe paisje tjera)” me numër të prokurimit 624-23-13123-5-5-8 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Botek shpk.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.12.2023, KOMUNA SUHAREKËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë ARITECH.

Me 13.12.2023, OE Botek shpk, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 15.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se Komisioni Vlerësues ka bërë vlerësimin real dhe të drejtë duke mbrojtur parandë publike dhe duke respektuar Ligjin e Prokurimit Publik.

Me 25.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Botek shpk. me nr. 1045/23 lidhur me aktivitetin “Furnizimi me paisje teknologjike (kompjuterat, lloptopa, videoprojektora dhe paisje tjera)” me numër të prokurimit 624-23-13123-5-5-8.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Botek shpk., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se “*Deklarata e specifikimeve teknike të cilën e ka dorëzuar OE i propozuar për kontratë, nuk është asgjë më shumë përveçse një deklarament shkruar se ky OE i përmbush me ofertën e tij specifikimet teknike sipas kërkesës së AK-së. Kjo deklaratë nuk përmbush kërkesat sipas FPO-së, Marrëveshjes publike kornizë (bazë për këtë procedurë të mini-tenderit), LPP-së dhe RRPP-së. Në Marrëveshjen Publike Kornizë (bazë për këtë Ftesë për Ofertim), shprehimisht kërkohet që për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që oferton. Në kolonën e parë të secilit produkt tek-Prodhuesi-Brand Name, duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni. Sipas Udhëzuesit, pika 10, AK duhet të veproj duke Refuzuar tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme, bazuar në neni 28 të LPP-së.*

Në vendimin e tyre, AK tenton të shtrembëroj faktet, duke paraqitur si provë një broshurë të OE të propozuar për kontratë, respektivisht broshurën për artikullin monitor. Në këtë aktivitet nuk janë kërkuar vetëm monitора por edhe PC dhe Laptop, për të cilat duhet të definohen se cilat opsione nga specifikimet ofertoohen. Edhe nëse OE i rekomanduar do të kishte nënvizuar opsionet me të cilat oferton dhe të cilat përmbushin kërkesat në Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme, përsëri sipas LPP, RRPP dhe Udhëzuesit ai do të duhej të eliminohej.”

Pretendimi i dytë (II) Ankuesi pretendon se *“Dokumentet e dorëzuara nga OE i dytë për nga çmimi, i cili po ashtu nuk ka dorëzuar një specifikim teknik të detajuar të produkteve që oferton, por vetëm ka dorëzuar dokumentin Deklaratë mbi Përshtatshmërinë dhe Afati i Liferimit përmes të cilit ka deklaruar thjeshtë se specifikimet teknike të ofruara nga ana jonë, përputhen me ato të Ankesit 1 të FPO-së. Edhe kjo, sikurse tek OE i propozuar për kontratë, nuk mjafton për të paraqitur produktet e ofruara.”*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2023/1045, ndërsa me datë 12.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2023/1045 me rekomandimet si në vijim: *“eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE është deklaruar se *“Ne deklarojmë se pajtohemi plotësisht me mendimin e ekspertës për pikën 2. Ndërsa për pikën 1, pajtohemi pjesërisht dhe deklarojmë se qëndrojmë prapa pretendimit se OE i propozuar për kontratë dhe tjetri OE, i dytë për nga çmimi, duhet të eliminohen nga procedura për shkak të mungesës së dokumentit esencial për vlerësim të tenderit, e i cili është Aneksi 1- Deklarata mbi specifikimet teknike, ashtu siç e konfirmon edhe ekspertja në raportin e saj. Sqarim: në këtë procedurë nuk janë kërkuar broshurat, mirëpo ato i kemi trajtuar për të vërtetuar edhe më tej përtej cdo dyshimi, që pavarësisht dorëzimit të tyre (edhe pse jo të kërkuara) OE i propozuar për kontratë duhet të eliminohet, sipas arsytimit të mësipërm dhe sipas UOPP që në rast të dorëzimit të broshurave, por mungesës së specifikacionit teknik të detajuar (në këtë rast Aneks 1), tenderi refuzohet pa kërkuar sqarime shtesë.”*

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 4 paragrafi 1, nën-paragrafin 75 të LPP, lidhur me nenin 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj mori në shqyrtim të shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë, sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Botek shpk ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/1045 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Ekspertja shqyrtuese sqaron se “ përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga AK që të dërgoj Ftesën për Ofertim e cila i është dërguar edhe operatorëve pjesëmarrës. Pjesë e kësaj ftese për ofertim ka qenë edhe Ankesi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme. Eksperti sqaron se OE i rekomanduar, nuk ka dorëzuar fare Aneksin 1 sipas FPO-së, por ai ka dorëzuar në ofertë vetëm disa broshura për produktet e kërkuara sipas Aneksi 1. Edhe pse në këto broshura janë produktet të cilat përmbajnë edhe specifikat e tyre teknike dhe të dhëna të tjera për pajisjet si çdo katalog apo broshurë tjetër, megjithatë mosplotësimi dhe mosdorëzimi me ofertë i Ankesi 1 përkatësisht specifikave teknike sipas FPO-së dhe Marrëveshjes Publike Kornizë, përbënë mosplotësim të kriterëve të kërkuara. Duke qenë se kërkesë e FPO-së nuk ka qenë që operatorët ofertues të dorëzojnë katalogun/broshurën, por vetëm specifikat teknike sipas Aneksi 1 të FPO-së, atëherë eksperti mendon se OE i rekomanduar nuk mund të eliminohet sipas pikës 10 të Udhëzuesit për Prokurim Publik, kur një kërkesë e tillë për katalog nuk është bërë nga ana e AK-së. Megjithatë, mosdorëzimi i Ankesi 1 me specifika teknike konsiderojmë që tregon një papërgjegjshmëri të OE i rekomanduar. Gjithashtu eksperti pasqyron se në ofertë OE i rekomanduar ka dorëzuar edhe një deklaratë (dokumenti 4 i ofertës) me të cilën operatori pranon se i përmbushë specifikat teknike sipas kërkesës, mirëpo në këtë deklaratë nuk është cekur asnjë e dhënë e produkteve përfshirë prodhuesin apo produktet e ofertuara. Gjithashtu vlen të theksohet se rast i ngjashëm është shqyrtuar edhe më parë nga paneli shqyrtues përkatësisht me- Vendimi i OSHP-së me numër 214/22. Vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II):Ekspertja shqyrtuese mendon “se OE i rënditur si i dyti për nga çmimi, nuk ka plotësuar specifikacionet teknike sipas Aneksi 1 të FPO-së. Një nga të dhënat të cilat nuk janë plotësuar fare nga ana e këtij operatori është pikërisht emri i brendit të produktit me të cilin oferton operatori dhe që është informacion mjaft i rëndësishëm në këtë lloj procedure. Në ofertën e këtij operatori ekonomik në asnjë pjesë të saj nuk ceket emri i brendit të produkteve me të cilat oferton. Edhe në deklaratën mbi përshtatshmërinë (pika 3 e ofertës) e dorëzuar me ofertë ku cekë se produktet janë në përputhje me specifikat teknike të kërkuara, prapë as ky dokument nuk përmbanë asnjë të dhënë sa i përket prodhuesit apo produkteve. Në të gjitha pjesët ku është kërkuar të plotësohet "Brand Name", asnjëra pjesë e kësaj kërkesë nuk është plotësuar, sipas Marrëveshjes Kornizë, për çdo produkt të ofertuar duhet specifikuar emri i modelit, përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit, gjë që ky operator nuk e ka specifikuar në asnjë pjesë të ofertës. Andaj, eksperti vlerëson se as operatori i dytë nuk e ka plotësuar Aneksi 1 sipas

kërkesave dhe konsideron që ky pretendim është i bazuar.”

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, ndonëse raporti i ekspertit nuk krijon efekte detyrues për Panelet Shqyrtuese të cilat ushtrojnë pavarësinë e plotë në zbatimin e kompetencave sipas nenit 105 të LPP, megjithatë çdo raporti i tillë, në çdo rast analizohet në kontekstin e vlerësimit, krahasimit dhe administrimit me të gjitha provat dhe i njihet vlera provuese në kontekstin e përgjithshëm të vendimmarrjes.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është mbështetur konstatimi i ekspertit shqyrtues i cili është mjaftë i detajuar dhe i argumentuar me prova dhe fakte dhe ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizimi me paisje teknologjike (kompjuterë, lloptopë, videoprojektora dhe paisje tjera)” me numër të prokurimit 624-23-13123-5-5-8 dhe kundërshtim me kërkesat e ftesës për ofertim konkretisht të Aneksit 1, ku OE efertues duhet të specifikojnë llojin, modelin, prodhuesin si dhe përshkrimin tjetër të produktit me të cilin ofertojnë, dhe në bazë të ofritit të specifikave duhet edhe të bëhet vlerësimi i ofertave.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA SUHAREKËS lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me paisje teknologjike (kompjuterë, lloptopë, videoprojektora dhe paisje tjera)” me numër të prokurimit 624-23-13123-5-5-8, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: